

Faleminderit Kryetar i Kuvendit,  
I nderuari z. President,  
Zoti Kryeministër,  
Të nderuar deputet,  
z. Ryker,  
Z. Feith  
Të nderuar përfaqësues ndërkombëtar,  
Të nderuar anëtarë të Qeverisë,  
Të dashur anëtarë të Komisionit Kushtetues  
Zonja dhe zotërinj,

Ndihem me fat sot që në emër të Komisionit Kushtetues të Republikës së Kosovës, që kam kënaqësi të rrallë, të veçantë në jetë si njeri dhe si vend, që për herë të parë në Kosovën e pavarur dhe sovrane, para Jush deputet të nderuar të Kuvendit të Republikës, para qytetarëve të Republikës sonë dhe botës demokratike të prezantojë draft kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Sot me këtë akt, më të lartin të shtetit tonë ne po e çmojmë luftën për lirinë dhe pavarësinë e fituar, paqen dhe po marrim përgjegjësinë të ndërtojmë të ardhmen për të gjithë ne dhe gjeneratat që vijnë në shtetin tonë të pavarur dhe demokratik.

Të nderuar deputet,

Ne, Komisioni Kushtetues i Republikës, çmojmë rrugëtimin tonë plotë sakrificë dhe tragjedi, por edhe krenari si popull dhe si njerëz gjatë shekullit,

Çmojmë të gjithë ata që synim kishin lirinë, pavarësinë, barazinë, demokracinë, Republikën dhe Kushtetutën që ranë në altarët e lirisë, Ju që jeni në këtë sallë dhe gjithë qytetarët e Kosovës të cilët morën pjesë aktive në shtet-ndërtimin tonë dhe botën demokratike që përkrahu paqen, drejtësinë, lirinë, pavarësinë dhe demokracinë në Kosovë. Ky rrugëtim mundësoj te bëjmë këtë Kushtetutë që po e miratojmë sot. Dhe ne si Komision Kushtetues i Republikës punën tonë në hartimin e Kushtetutës dhe këtë kushtetute u'a dedikojmë qytetarëve të Republikës sonë, të rënëve dhe të gjallëve.

Deputet të nderuar,  
Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni të prezantoj shkurtimisht përmbajtjen e Kushtetutës sonë e cila ka 14 kapituj dhe 162 nene. Kemi synuar të kemi një Kushtetutë moderne, të shkurtër, të qartë dhe të kuptueshme që garanton vullnetin e qytetarëve të Kosovës dhe zotimet ndërkombëtare dhe që është funksionale.

Sot, në duart tuaja është drafti i Kushtetutës së Republikës së Kosovës si bazë e ndërtimit të sistemit politik, ekonomik dhe shoqëror në shtetin tonë në të cilën kemi shprehur synimet tona, në emër të popullit të Kosovës, për të ardhmen e vendit tonë të lirë, demokratik dhe paqedashës si shtet i të barabartëve.

Kushtetuta fuqizon Republikën tonë si shtet të pavarur, sovran, demokratik, unik dhe të pandashëm.

Sovranitetin e Republikës sonë Kushtetuta e përcakton se buron nga populli dhe i takon atij. Ajo garanton integritetin territorial të Kosovës si të pacenueshëm, të patjetërsueshëm dhe të pandashëm dhe që mbrohet me të gjitha mjetet e lejuara.

Republika e Kosovës është e ndërtuar mbi bazën e konceptit të barazisë qytetare dhe e definuar si shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe nga komunitetet e tjera e cila qeveriset në mënyre demokratike dhe respektohet plotësisht sundimi i ligjit dhe barazia e qytetarëve para tij.

Kosova jonë është definuar Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit dhe baraspeshës ndërmjet tyre, duke definuar Kuvendin si organin me të lartë legjislativ, ku Presidenti i Republikës përfaqëson unitetin e popullit dhe është garantues i funksionimit demokratik të institucioneve, me Qeveri e cila është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe të politikave shtetërore dhe që i përgjigjet kontrollit parlamentar. Me këtë Kushtetutë kemi institucionalizuar pushtetin, por edhe kemi bërë kufizimin e tij.

Kushtetutën e kemi kuptuar si kontratë ndërmjet qytetarëve për ngritjen dhe ushtrimin e politikave publike.

Me këtë Kushtetutë shteti ynë ka rend kushtetues që bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës për pronën, mbrojtjes së mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ekonomisë së hapur të tregut, dhe barazisë.

Republika e Kosovës është shtet laik dhe neutral në çështje të besimeve fetare.

Shtetasit tanë brenda dhe jashtë vendit do të kenë garanci kushtetuese dhe kujdesin e shtetit të tyre.

Republika jonë si subjekt ndërkombëtar, ka mundësi të bëjë marrëveshje ndërkombëtare dhe të anëtarësohet në mekanizmat ndërkombëtarë. Ne marrim obligime për respektimin e së drejtës ndërkombëtare.

Të nderuar deputet,  
Zonja dhe zotërinj,

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë një kapitull i rëndësishëm i kësaj kushtetute ku garantohej respektimi, mbrojtja dhe përmbushja nga ana e shtetit të Kosovës sipas standardeve më të larta ndërkombëtare.

Një kapitull i veçantë janë të drejtat e komuniteteve duke i përcaktuar parimet e këtyre të drejtave, përgjegjësitë e shtetit për këto të drejta, institucionet adekuate dhe përfaqësimin e komuniteteve në institucione publike në nivel qendror dhe komunal. Këto të drejta burim kanë pasur dokumentin e Presidentit Ahtisaari.

Sistemi i drejtësisë garantohej me këtë Kushtetutë. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, i paanshëm, apolitik dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.

Një institucion i ri dhe i pavarur është Gjykata Kushtetuese si autoritet përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe për të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputet,

Republika e Kosovës me këtë Kushtetute garanton ekonominë e tregut me konkurrencë të lirë dhe siguron pronën private dhe publike, si dhe siguron të drejta ligjore të barabarta për të gjithë investitorët dhe ndërmarrjet vendore dhe të jashtme. Garantohej konkurrenca e lirë, mbrojtja e konsumatorëve por edhe obligimi i qytetarëve që të paguajnë tatimet dhe kontributet e parapara me ligje.

Kushtetuta obligon që shpenzimet e financave publike dhe mbledhja e tyre duhet të bazohen në parimet e llogaridhënies, efektshmërisë, efikasitetit dhe transparencës. Pra taksapaguesi ynë do të njoftohet për shpenzimin publik të parave të tyre. Edhe përdorimi i pasurisë dhe burimeve natyrore garantohej me Kushtetutë.

Qeverisja lokale garantohej si nivel i pushtetit që bazohet në qeverisje të mirë, transparencë, efikasitet dhe efektivitet në ofrimin e shërbimeve publike.

Të nderuar deputet,

Republikës sonë i garantohej institucionet e plota të sigurisë, të cilat do të kenë kontroll civil dhe demokratik. Forca e Sigurisë së Kosovës është forcë kombëtare e sigurisë së Republikës sonë me të drejtë të dërgoje trupat e saj jashtë vendit në misione paqësore. Kjo forcë do të jetë profesioniste.

Republika e Kosovës do të ketë edhe Këshillin e Sigurisë si institucion që përgatitë strategjinë e sigurisë së Republikës sonë.

Republikës sonë i garantohet funksionimi i policisë profesionale, si Agjencia e Kosovës për Inteligjence si dhe Autoriteti Civil i Aviacionit si institucion që ofron shërbime të navigacionit ajror.

Institucionet e pavarura si Avokati i Popullit, Auditori i Përgjithshëm, Komisioni Qendror Zgjedhor, Banka Qendrore, Komisioni i Pavarur i Mediave si institucione të krijuara nga Kuvendi me të cilat garantohet pavarësia nga çdo organ apo autoritet tjetër në Republikën e Kosovës. Me ligj mund të themelohen edhe agjencitë tjera që Kuvendi i konsideron të domosdoshme.

Kjo Kushtetutë ka dispozitat përfundimtare që japin një pasqyrë për interpretimin dhe amandamentimin e Kushtetutës.

Karakteristikë e kësaj Kushtetute janë dispozitat kalimtare që normojnë gjendjen ekzistuese nën mbikëqyrje ndërkombëtare të shtetit tonë dhe bashkëpunimin në mes institucioneve vendore dhe prezencës ndërkombëtare, por janë edhe mundësi që me kalimin e fazës së tranzicionit këto kompetenca të përfundojnë – të shfuqizohen pa prekur esencën e Kushtetutës.

Është theksuar që kjo Kushtetutë hyn në fuqi me 15 qershor të këtij viti dhe nëse lexojmë dispozitat e kësaj Kushtetute ajo nënkupton se me hyrjen në fuqi të gjitha institucionet ekzistuese të Kosovës marrin kompetencat në përputhje me këtë Kushtetute, pra kompetencat e plota shtetërore.

Të nderuar deputet,

Ne po mundësojmë që të normohet ambienti dhe shteti ku jetojmë, ju thërrasim për mbështetje për projektin që është bërë në përputhje me kohën e shtet-ndërtimit tonë dhe zotimeve ndërkombëtare që ka bërë Republika e Kosovës.

Besojmë shumë se kjo Kushtetutë do të forcoj lirinë, pavarësinë, prosperitetin dhe demokracinë e shtetit tonë. Kjo Kushtetute mbron hapur dhe fuqishëm vlerat që duhet ta sundojnë shtetin tone në përputhje me botën e civilizuar.

Kjo Kushtetutë do të respektoj të drejtat e secilit qytetar të Republikës duke u nisur nga premisa se asnjëherë askush nuk do të jetë vërtet i lirë, derisa të gjithë njerëzit të mund t'i gëzojnë të njëjtat liri.

Jemi inspiruar nga shumë hartues dhe Kushtetuta të vendeve moderne dhe demokratike ku edhe i kemi krahasuar, duke respektuar edhe traditën juridike të vendit tonë.

Të nderuar deputet,  
Zonja dhe zotërinj,  
Të nderuar qytetar të Republikës,

Kam kënaqësinë t'u njoftojë se ne, Komisioni Kushtetues i Republikës së Kosovës, jemi përpjekur që gjithë fuqinë tonë njerëzore dhe intelektuale t'a bartim me kujdes tek ky draft i Kushtetutës sonë.

Mbi bindjet tona partiake, etnike dhe profesionale ka dominuar ndjenja dhe nevoja e përbashkësisë për shtetin dhe qytetarët tanë dhe draftin sot që e kemi prezantuar e kemi miratuar me konsensus të plotë.

Të nderuar deputet,  
Zonja dhe zotërinj  
Të nderuar anëtarë të Komisionit Kushtetues,

Me lejoni në fund që t'u ftoj t'a aprovoni këtë Kushtetutë, deputetë të nderuar me bindje se është një akt, bazament i shtetit tonë që forcon institucionet e Kosovës sonë dhe bindjen e bashkësisë ndërkombëtare për zotimet tona dhe jep orientimin tonë si vend përkrah shteteve të përparuara.

Me lejoni te falënderojë Presidentin, Kryeministrin, Kryeparlamentarin, të gjitha partitë politike, gjithë qytetarët e Kosovës dhe ekspertet vendor dhe ndërkombëtarë për mbështetjen e plotë, të sinqertë dhe shumë cilësore, në veçanti anëtarët e Komisionit për punën e përbashkët, përkushtimin e madh, kohën e gjatë, për durimin, respektin për mua dhe njëri-tjetrin, përgjegjësinë dhe ato mendime që keni dhënë në qindra takime.

Dhe sot ashtu sikur kemi thënë, kemi bërë një Kushtetutë për asnjërin veç e veç, por për të gjithë ne në shtetin tonë.

Ju faleminderit për vëmendje.